



**INFORMOHU!  
MBROHU!**



# LUFTO KUNDËR DHUNËS!

## Drejtohu tek:

### 1. Qendra për punë sociale (QPS)

Merr masa, për ta parandaluar dhunën e mëtejshme dhe ti ndihmoj viktimës që ti tejkaloj pasojat e dhunës dhe të krijoj kushte për integrimin e tyre në mjedisin social.

- ngren procedurë në rastet e dhunës në familje në bazë të ankesës së parashtruar;
- në rast të rrezikut serioz ndaj viktimës, QPS-ja thërret policinë dhe kërkon ndihmën e tyre / ndërhyrjen;
- siguron ndihmë të nevojshme për personin – viktimën e dhunës, e cila mund të zgjasë deri në gjashtë muaj, me mundësi vazhdimi edhe për gjashtë muaj të tjerë;
- siguron kujdes shëndetësor adekuat, ndërhyrje dhe trajtim psiko-social;
- i udhëzon në këshillimore të përshtatshme;
- jep çdo lloj të ndihmës juridike. E përfaqëson viktimën dhe ngren procedurë para gjykatës kompetente.

### 2. Ministria për punë të brendëshme (MPB)

Kompetenca e policisë në fushën e dhunës në familje, është mbrojtja e personave - viktimave, zbulimin e kryerësve, luftimin dhe parandalimin e dhunës në familje. Në rast të denoncimit të dhunës në familje ose gjatë kërkesës për ndihmë të një personi të ekspozuar ndaj çdo lloji të dhunës në familje, personi zyrtar është i detyruar të veproj dhe ti siguroj të gjitha provat e nevojshme për zbatimin e suksesshëm të procedurës penale. Policia rastet e dhunës në familje i regjistron, bën hetimin në vendin e ngjarjes dhe vepron në përputhje me masat e përkohshme për mbrojtje nga dhuna në familje (të parapra në Ligjin për Familje në RM, neni 104)

Sistemi për mbrojtjen nga dhuna në familje në Republikën e Maqedonisë përfshin një numër të madhë të masave, mekanizmave dhe institucioneve për mbështetje dhe ndihmë për viktimat

### 3. Institucionet shëndetësore

Punonjësit shëndetësor i ndërmarrin ndërhyrjet e mëposhtme:

- Vlerësimin e gjendjes shëndetësore të viktimës;
- Vlerësimin e sigurisë së viktimës dhe rrezikun nga dhuna;
- Përcaktimin e natyrës dhe llojin e dhunës;
- Raport me shkrim – dosje e pacientit;
- Nëse është përdorur armë ose kërcënim me armë apo është përdorur alkool, drogë patjetër duhet ta informojë policinë;

Punonjësi shëndetësor, në varësi prej llojit të lëndimit apo gjendjes shëndetësore të viktimës i sugjeron referenca të tjera të mundshme të institucioneve përkatëse që ofrojnë ndihmë juridike, sociale apo lloj tjetër të ndihmës. Për çdo rast informohet edhe këshilltari për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve në institucione.

### 4. Organizatat qytetare të cilat punojnë në fushën e dhunës në familje

Shoqëria civile konsiderohet si subjekt i barabartë me institucionet e tjera që punojnë në identifikimin, parandalimin, dhënien e ndihmës psiko-sociale dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje. Ekzistojnë organizata që ofrojnë ndihmë ligjore falas për viktimat e dhunës në familje; ofrojnë ndihmë psiko-sociale dhe mbështetje; sigurojnë strehim për viktimat në strehimore; disponojnë me SOS linjë për raportimin e dhunës.

Organizata qytetare është e detyruar në varësi prej nevojës të viktimës të bëjë një referim të përshtatshëm në organizatë tjetër që mund ti ofrojë ndihmë viktimës si strehim, ndihmë juridike falas dhe mbështetje psiko-sociale.

MOS U BËJ DHUNUES,

ME DHUNË NUK ZGJIDHEN  
PROBLEMET!

Numra telefoni më të rëndësishme për  
ndihmë dhe mbështetje:

- SOS LINJA TELEFONIKE PËR FEMRA DHE FËMIJË  
VIKTIMA TË DHUNËS NË FAMILJE

**(02) 15 700 dhe (02) 15 315**

- STREHIMORE PËR FEMRA DHE FËMIJË VIKTIMA TË  
DHUNËS

**070/520-639**



Iniciativa qytetare e femrave ANTIKO

[www.antiko.org.mk](http://www.antiko.org.mk)

e-mail: [contact@antiko.org.mk](mailto:contact@antiko.org.mk); [antiko@t-home.mk](mailto:antiko@t-home.mk)



Ky publikim, u mundësua në suaza të programit CIVICA Mobilitas – implementuar nga CIRa dhe finansuarisht e mbështetur nga SDC. Mendimet e shprehura këtu janë mendime të autorit/autorëve dhe nuk i reflektojnë qëndrimet e CIRa-së dhe SDC-së.